



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 176

Tiranë – E enjte, 7 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 342, datë 30.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 21481
Dekret i Presidentit nr. 343, datë 30.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 21481
Dekret i Presidentit nr. 344, datë 30.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 21481
Dekret i Presidentit nr. 345, datë 30.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 21482
Dekret i Presidentit nr. 346, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21482
Dekret i Presidentit nr. 347, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21482
Dekret i Presidentit nr. 348, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21483
Dekret i Presidentit nr. 349, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21483
Dekret i Presidentit nr. 350, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21483
Dekret i Presidentit nr. 351, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21483
Dekret i Presidentit nr. 352, datë 30.11.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 21484

Dekret i Presidentit nr. 353, datë 30.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	21484
Dekret i Presidentit nr. 354, datë 30.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	21484
Dekret i Presidentit nr. 356, datë 4.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	21485
Dekret i Presidentit nr. 357, datë 4.12.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	21485
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 654, datë 30.11.2023	Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fundvitit 2023.....	21485
Urdhër i Kryeministrit nr. 208, datë 4.12.2023	Për delegim kompetence.....	21487
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 23.11.2023	Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” (i ndryshuar).....	21487
Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 5, datë 23.11.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 5, datë 2.4.2019, të Këshillit për Emërime në Drejtësi, “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.....	21489
Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 296, datë 19.10.2023	Mbi miratimin e amendimit nr. 3 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a”.....	21490
Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 297, datë 19.10.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	21496
Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 298, datë 19.10.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese), për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	21497
Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 299, datë 19.10.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Truen” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.....	21499
Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 300, datë 19.10.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “WEnerg” sh.a., për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e saj..	21500
Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë nr. 349, datë 22.11.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.7.2023, “Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa shqiptare e energjisë elektrike ALPEX’ sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”.....	21501

**DEKRET****Nr. 342, datë 30.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Anri Agron Kodhelaj
2. Charlotte Ambrosa Anri Kodhelaj
3. Agi Gëzim Zenaj
4. Fabio Igli Hoxha
5. Julia Ilmet Koçi
6. Zenel Huzri Hoxha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 343, datë 30.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Xhesika Muhamed Koroveshi
2. Xhuljana Latif Jaçe
3. Anisa Fatmir Souček (Haxhi)
4. Borana Selim Luli
5. Suad Besnik Mahmuti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 344, datë 30.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Andi Fiqiri Balza
2. Ani Refik Lasku
3. Hans Bajram Bruzja

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**DEKRET****Nr. 345, datë 30.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Iu lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bora Feim Muhaj
2. Tomë Nikoll Muslia
3. Aron Tomë Muslia
4. Gabriel Tomë Muslia
5. Isabel Tomë Muslia
6. Brunilda Tomorr Hasanaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 346, datë 30.11.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 6, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

Faqe | 21482

1. Nehat Isak Hoxhaj
2. Naser Garip Arifaj
3. Gent Shkelzen Meqa
4. Rilinda Fadil Selimaj
5. Kreshnik Ymer Mariqi
6. Merita Miftar Kabashi
7. Bashkim Miftar Kabashi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 347, datë 30.11.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Bekim Agim Bardhi
2. Besiana Rufat Sinanaj Morina
3. Leon Jeton Pruthi
4. Fitore Selajdin Boshnjaku Halili

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 348, datë 30.11.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dren Besart Shala
2. Fatos Hylki Zeka
3. Tauland Hylki Zeka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 349, datë 30.11.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dion Arben Doli
2. Jeton Ismen Kadriaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 350, datë 30.11.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Teuta Mehdi Jashari Kajtazi
2. Laura Hasan Pruthi (Lipoveci)
3. Boena Besart Shala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 351, datë 30.11.2023****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Pranvera Ebib Bytyqi (Islamaj)
2. Selajdin Fahredin Boshnjaku
3. Evgjenije Skender Shala (Kokaj)
4. Fitore Isen Hoxhaj (Gutaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 352, datë 30.11.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënie e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Fatjona Dugagjin Kabashi
2. Kadire Deli Çoçaj (Guci)
3. Veton Elez Sezallari
4. Vjollca Rifat Durguti (Qevani)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 353, datë 30.11.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Naidi Hysen Çela
2. Alba Namik Pacani (Xhaferaj)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 354, datë 30.11.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Eltjona Mevlud Kodhelaj
2. Verart Rahman Hoxha
3. Eno Ilirian Thomallari
4. Felisiti Eno Thomallari



5. Ian Ragnar Eno Thomallari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 356, datë 4.12.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit:
- Ahmad Jalal Arnaout

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 357, datë 4.12.2023

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, e nenit 93 të Kushtetutës; të nenit 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të shtetasit:
- Francesco Ugo De Luca

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 654, datë 30.11.2023

**PËR SHPËRBLIMIN E PENSIONISTËVE
PËR FESTAT E FUNDVITIT 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin në masën 5 000 (pesë mijë) lekë të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat, që përfitojë pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) Personat, që përfitojnë pension, sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;



c) Personat, që përfitojnë pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) Personat, që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

dh) Personat, që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) Personat, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

ë) Personat, që nuk përfitojnë pension, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

f) Personat, që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

g) Personat, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”.

2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që iu lind e drejta për përfitimin e pensionit deri në datën 31.12.2023, përfshirë edhe këtë datë dhe kanë të drejtë ta marrin vetëm një herë këtë shpërblim, pavarësisht se mund të përfitojnë më shumë se një përfitim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 3 548 377 000 (tre miliardë e pesëqind e dyzet e tetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, e ndarë në 3 520 215 000 (tre miliardë e pesëqind e njëzet milionë e dyqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë për shpërblimin dhe 28 162 000 (njëzet e tetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit. Efektet financiare përballohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i miratuar për vitin 2023.

4. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2023 dhe paguhën gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2023, ato të paguhën gjatë vitit 2024. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen pas datës 31.12.2024.

5. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Posta Shqiptare sh.a., si dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi, dhe autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve, sipas programeve në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



URDHËR

Nr. 208, datë 4.12.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 3, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, znj. Arlinda Hoti, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Trajnimit dhe Komunikimit, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

2. Delegimi i kompetencave të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij urdhri dhe të mbarojë me shfuqizimin e tij.

3. Urdhri nr. 79, datë 9.5.2022, i Kryeministrit, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet znj. Arlinda Hoti, drejtor i Drejtorisë së Trajnimit dhe Komunikimit, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 4, datë 23.11.2023

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 4, DATË 11.3.2019, TË
KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË
DREJTËSI, “PËR PROCEDURËN E
VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR
POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN
KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT
TË LARTË TË DREJTËSISË”
(I NDRYSHUAR)**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (i ndryshuar), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI

Në vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 3, fjalia e dytë riformulohet si vijon:

“Mbledhja zhvillohet brenda 5 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e këshillit të dokumentacionit dhe listës së kandidatëve për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet që vënë në lëvizje Këshillin e Emërimeve në Drejtësi dhe publikimit të listës së kandidatëve për pozicionin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga ana e këtij Këshilli”.

2. Pika 7, pas fjalës së parë, shtohet fjalia si vijon:

“...jo më vonë se afatet e përcaktuara nga relatori në zbatim të pikave 22, 23, 26, 27 dhe 48. Me kalimin e këtyre afateve çdo pretendim i paraqitur nga kandidati nuk do të merret në konsideratë”.

3. Pas pikës 22, shtohet pika 22/1, si vijon:

“22/1. Kur kandidati, pa shkaqe të arsyeshme, nuk paraqitet brenda afatit 3 ditor të kërkuar nga relatori, apo nëse nuk dorëzon dokumentacionin e tërhequr apo autorizimet, sipas parashikimeve të pikës 22, brenda 5 ditëve nga momenti i tërheqjes së tyre në sekretarinë e Këshillit, relatori ndërpret procedurën për këtë kandidat dhe përgatit relacionin dhe projektvendimin për mosshqyrtimin e kandidaturës, duke ia dërguar menjëherë për shqyrtim KED-it.”

4. Pika 23 riformulohet si vijon:

“23. Shqyrtimi i kandidaturave të paraqitura bëhet në bazë të dokumentacionit shoqërues të paraqitur nga kandidati me të cilin vërtetohet plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati me të cilin vërtetohet plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore është sipas lidhjes nr. 2 të këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Nëse nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori konstaton dhe vlerëson se ai është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës së posaçme të Këshillit në Gjykatën e Lartë, dhe për arsye të justifikuar, mund ta shtyjë afatin, me kërkesë të kandidatit, dhe 5 ditë tjera. Njoftimi përmban shënimin se ne rast të mosparaqitjes së dokumenteve brenda afatit, procedura e shqyrtimit



të kandidaturës ndërpritet. Kur kandidati nuk plotëson të metat e dokumentacionit brenda afatit të caktuar nga relatori, çdo veprim tjetër i kryer lidhur me këtë kandidat ndërpritet dhe relatori përgatit relacionin dhe projektvendimin për mosshqyrtimin e kandidaturës, duke ia dërguar menjëherë për shqyrtim KED-it.”

5. Pika 24 riformulohet si vijon:

“24. Pas realizimit të procedurave të parashikuara në pikat 22 dhe 23 të këtij vendimi, relatori procedon me dërgimin e shkresave standarde për kërkimin e informacionit zyrtar që disponojnë institucionet publike si dhe kur lind nevoja e riverifikimit të të dhënave dhe shpjegimeve të paraqitura nga kandidati, pranë institucioneve publike dhe subjekteve private.”

6. Pika 26, pas shkronjës “b”, shtohet fjalia si vijon:

“Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet kur kandidati nuk zbaton parashikimet në pikat 22 dhe 23 të këtij vendimi.”

7. Pika 28 riformulohet si vijon:

“Në rastin kur, në përfundim të afatit të njoftimeve sipas pikave 26 dhe 27 të këtij vendimi, kandidati nuk paraqitet, nuk i përgjigjet njoftimeve të Këshillit, nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar ose nuk parashtron shpjegime me shkrim për gjetjet e procedurës së verifikimit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe problemet ligjore të konstatuara dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.”

8. Pika 48 riformulohet si vijon:

“Në rastin kur relatori paraqet relacionin e kandidatit për shqyrtim Këshillit dhe pas shqyrtimit të relacionit dhe të akteve që përmban dosja e kandidatit të verifikuar, Këshilli vjen në përfundimin që ka vend për të vlerësuar edhe mundësinë e ndalimit të kandidimit, si dhe për këtë kandidat nuk janë ndjekur procedurat e përcaktuara në pikat 26 dhe 27 të këtij vendimi, ndërpret shqyrtimin e këtij kandidati.

Kandidatit të verifikuar i njoftohet materiali me gjetjet dhe motivet të cilat mund të sjellin ndalimin e kandidimit, duke i njohur të drejtën e parashtrimit me shkrim të shpjegimeve të tij dhe dokumenteve mbështetës, jo më vonë se 5 ditë nga ajo e ardhjes në dijeni të materialit të dërguar nga Këshilli. Në përfundim të këtij afati, Këshilli shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e kësaj kandidature.”

9. Në pikën 60, shkronja “b”, shfuqizohet.

10. Pika 62 riformulohet si vijon:

“62. ILDKPKI-ja njofton menjëherë Këshillin në rastin kur kandidati nuk e dorëzon të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë ose kur kandidati e dorëzon jashtë afatit të parashikuar në pikën 61 të këtij vendimi”.

11. Në pikën 64, fjalia e fundit riformulohet si vijon:

“Në çdo rast, Këshilli, nëse ka dyshime të arsyeshme kryen veprimet e parashikuara nga pika 67 fjalia e dytë e këtij vendimi”.

12. Pika 66 riformulohet si vijon:

“66. Në përfundim të verifikimit të kryer sipas ligjit, ILDKPKI-ja i dërgon menjëherë Këshillit raportin e kontrollit të plotë për pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe personave të lidhur, së bashku me dokumentacionin e administruar gjatë procedurës së verifikimit.”

13. Pika 67 riformulohet si vijon:

“67. Relatori shqyrton dhe verifikon rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, si edhe dokumentacionin e dërguar prej këtij të fundit. Relatori kur ka dyshime të arsyeshme apo kur ka mospërputhje midis gjetjeve dhe përfundimeve të ILDKPKI-së, pas miratimit të Këshillit, fillon procedurat për kryerjen e veprimeve të kërkimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit dhe personave të lidhur.”

14. Pas pikës 92, shtohet pika 92/1 me përmbajtje si vijon:

“92/1. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori vlerëson se nuk është nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme lidhur me dokumentacionin, për shkak se të dhënat e deklaruara janë të plota, kanë përmbajtje të saktë ose nuk gjenden elemente që sjellin dyshime të bazuara për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, ai vijon me procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit.”

15. Në pikën 93, fjalia e parë, riformulohet si vijon:

“93. Kur nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori vlerëson se të dhënat e deklaruara nuk janë të plota, përmbajnë



pasaktësi ose edhe elemente që sjellin dyshime të bazuara për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, ai, pas miratimit të Këshillit, me vendim të arsyetuar përcakton dokumentet për të cilat është e nevojshme riverifikimi i të dhënave, duke kërkuar për këtë qëllim.”

16. Pas pikës 97, shtohet pika 97/1, me këtë përmbajtje:

“97/1. Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e parashikuar, nga neni 7/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, “Për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese”, në lidhje me përvojën 15 vjet “jurist i nivelit të lartë në administratën publike”.

Kandidati “jurist i nivelit të lartë në administratën publike” për qëllim të këtij vendimi, do të konsiderohet juristi i cili ushtron apo ka ushtruar një detyrë të nivelit të lartë drejtues në organet e sistemit të drejtësisë apo administratën publike përmes së cilës ka arritur të akumulojë ndër vite gjatë karrierës së tij/saj një eksperiencë të pasur profesionale lidhur me çështje të së drejtës kushtetuese, të të drejtave të njeriut, të së drejtës publike, që e lejon të japë një kontribut me kualifikim të lartë profesional dhe vlera të çmueshme juridike në juridiksionin kushtetues”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Sandër Simoni

Zëvendëskryetar: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Fuat Vjerdha, Arta Marku, Engert Pëllumbi, Gjon Fusha, Enerjeta Shehaj, Arqilea Koça

Lidhja nr. 2

Lista e dokumenteve që duhet të paraqesë kandidati me të cilën vërtetohet plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore

Kushtet dhe kriteret	Lloji i dokumentit
Zotësi të plotë për të vepruar	Vërtetim nga zyra e gjendjes civile se ndaj kandidatit nuk është marrë vendim për heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar <i>(për kandidatët që nuk vijnë nga radhët e gjyqësorit apo të administratës publike)</i>
Arsimi i lartë juridik (diplomë e nivelit të dytë)	Diplomë dhe listë notash e lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë

	Diplomë dhe listë notash e njësuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore në rastin kur studimet janë kryer jashtë vendit
Mosqenia në procedim penal dhe mosdënimi me burgim për kryerjen e një vepre penale	Vërtetim i lëshuar pas datës së shpalljes së thirrjes për shprehjen e interesit nga prokuroria dhe gjykata se ndaj kandidatit nuk ka filluar procedim penal si dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore <i>(dëshmia e penalitetit)</i>
Largim nga detyra për shkaqe disiplinore dhe mospasja e një mase disiplinore në fuqi	Libreza e punës, vërtetim të lëshuar nga punëdhënësi
Vjetërsia në profesion	Libreza e punës, vërtetimi lëshuar nga punëdhënësi, vërtetim sipas rastit nga Dhomat Profesionale me anëtarësi të detyruar, nga QKB apo nga organet tatimore, në rastin e të vetëpunësuarit

VENDIM

Nr. 5, datë 23.11.2023

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 5, DATË 2.4.2019, TË KËSHILLIT PËR EMËRIME NË DREJTËSI, “PËR KRITERET DHE PROCEDURËN E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE, PËR POZICIONET VAKANTE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 229, dhe të pikës 6, të nenit 240, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (i ndryshuar), Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 5, datë 2.4.2019, të Këshillit për Emërime në Drejtësi, “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, bëhet shtesat e mëposhtme:

1. Pas pikës 15, shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje si vijon:

“15/1. Për kandidatët të cilët kanë aplikuar në më shumë se një vakancë për gjyqtar të Gjykatës



Kushtetuese, Këshilli duhet të bëjë vlerësimin dhe pikëzimin njëkohësisht në të gjitha vakancat.

Në rast pamundësie të vlerësimit dhe pikëzimit njëkohësisht për të gjitha vakancat, pasi shkelen afatet ligjore, Këshilli bënë vlerësimin dhe pikëzimin individualisht për secilën vakancë. Në këtë rast kandidati i vlerësuar dhe i pikëzuar për njëren vakancë nuk i nënshtrohet më kësaj procedure për vakancat e tjera. Përfundimisht, kur kandidati i pikëzuar më parë, arrin të sigurojë dokumente të reja mbas momentit të vlerësimit të mëparshëm dhe që i shërbejnë vlerësimit të tij, Këshilli për këtë komponent bën rivlerësimin dhe ripikëzimin përkatës. Dokumenti i ri duhet të paraqitet të paktën një ditë përpara nga dita e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit për përcaktimin e pikëzimit të kandidatit. Dokumentacioni që zotërohet nga kandidati dhe që nuk është paraqitur më parë për vlerësim, nuk do të merret më në konsideratë edhe nuk do të bëhet pjesë e rivlerësimit nga Këshilli.”

2. Pas pikës 18, shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje si vijon:

“18/1. Kandidati ka detyrimin ligjor që të jetë bashkëpunues, korrekt dhe të mos kryejë veprime që zvarrisin pa arsye procesin e vlerësimit dhe pikëzimit. Sjellja e tij/saj në raport me procesin e vlerësimit do të jetë pjesë e vlerësimit nga Këshilli. Kandidatët për çdo pretendim apo për paraqitjen e dokumentacionit, duhet të respektojnë afatet e caktuara nga relatori dhe gjithmonë jo më vonë se 2 ditë para mbledhjes ku do të shqyrtohet kandidatura konkrete.”

3. Në pikën 66, mbas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Çdo anëtar i Këshillit duhet të argumentojë, për secilin kriter vlerësimi, masën e pikëve që i ka caktuar kandidatit.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Sandër Simoni

Zëvendëskryetar: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Fuat Vjerdha, Arta Marku, Arqilea Koça, Engert Pëllumbi, Gjon Fusha, Enerjeta Shehaj

VENDIM

Nr. 296, datë 19.10.2023

MBI MIRATIMIN E AMENDIMIT NR. 3 TË KONTRATËS “PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA DHE KESH SHA”

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, 47, 56, germa “P”, 62 dhe 90 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pjesës I, nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së nr. 449, datë 26.7.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2134/1 prot., datë 16.10.2023, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi amendimin nr. 3 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 12.9.2022, miratoi kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën 2.7.2022 deri më 31.12.2022. Kontrata e miratuar nga ERE i ka shtrirë efektet juridike nga 2.7.2022 deri më 31.12.2022.

- Qeveria shqiptare nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, shpalli gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Ndërsa, me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me



energji elektrike”, gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike u shty deri më datë 30.6.2023.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 30, datë 16.2.2023 miratoi amendimin nr. 1 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit”, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. dhe Korporatës Elektroenergetike Shqiptare (KESH) sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 12.09.2022, i cili i shtyu efektet juridike të kësaj kontrate nga data 31 dhjetor 2022 deri më datë 30 qershor 2023.

- Hyrja në fuqi e VKM-së nr. 449, datë 26.7.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar, e shtyu gjendjen e emergjencës së furnizimit me energji elektrike deri më 31 dhjetor 2023.

- Palët kanë shprehur vullnetin e tyre për amendimin e kontratës, duke e nënshkruar bashkërisht atë, për ndryshimin e kohëzgjatjes së kontratës, dhe shtrirjen e efekteve të saj deri më datë 31.12.2023, duke përcjellë kontratën në ERE me shkresë të përbashkët ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., me nr. 2134 prot. të ERE, datë 11.9.2023, “Për amendimin e kontratës ‘Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit’”, të miratuar dhe të nënshkruar ndërmjet palëve OST sh.a dhe KESH sh.a.

- Gjithashtu, me qëllim konsultimin publik të këtij amendimi u realizua publikimi i tij në faqen zyrtare të internetit të ERE-s më datë 15.9.2023 dhe deri në këtë vendimmarrje nuk ka pasur asnjë koment për këtë dokument nga palët e interesit.

- Ndryshimi i kohëzgjatjes së kontratës vjen si pasojë e zgjatjes së periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më datën 31.12.2023, sikurse shprehet në VKM-në nr. 449, datë 26.7.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021, ‘Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (të ndryshuar)’”. Pika 2 e VKM-së nr. 449/2023 përcakton se në pikën 5 fjalët “... 30 qershor 2023.” zëvendësohen me “... 31 dhjetor 2023.”.

Në këtë amendim kontrate të përcjellë në ERE me shkresën e përbashkët ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a., me nr. 2134 prot. të ERE, datë 11.9.2023,

vlerësohet se duhet të ndryshohet emërtimi i vitit në aneksin 1 të kontratës, “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit”, miratuar me vendim e Bordit të ERE-s nr. 230. datë 12.9.2022, i cili trajton rakordimet të energjisë së livruar nga KESH sh.a. dhe energjisë së pranuar nga OST sh.a., konkretisht vlerësohet se më datë _____.2022 duhet të ndryshojë dhe të bëhet _____.2023, për sa kohë që efektet juridike të kësaj kontrate përfundojnë më 31 dhjetor 2023. Rakordimet e energjisë të paraqitura në formë tabelore konfirmohen dhe nënshkruhen nga palët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e amendimit nr. 3 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe KESH sh.a. (amendimi bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Ndryshimi i emërimit të Annex 1 “Raport-Rakordimi” të kontratës me nr. 4670 prot., datë 27.7.2022 (OST sh.a.) dhe nr. 3635 prot., datë 27.7.2022 (KESH sh.a.), “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit”, miratuar me vendim e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 12.9.2022, periudha “Më datë _____.2022” ndryshon dhe bëhet “Më datë _____.2023”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1.7.2023 deri më 31.12.2023.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



Nr. 4600 prot., Tiranë, më 06.09.2023

Nr. 4488 prot., Tiranë, më 08.09.2023

AMENDIMI NR.3

I

KONTRATËS

PËR

SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E

HUMBJEVE

NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT

ndërmjet

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

OST SHA

DHE

**KORPORATES ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE
KESH SHA**



Sot në datë _____.2023, duke u mbështetur në vullnetin e lirë të:

- (1) **Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH SHA.**, shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.12728, datë 06.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në: Bllokun “Vasil Shanto”, Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga Z. Ergys Verdho, Administrator i Shoqërisë KESH SHA., që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

Dhe

- (2) **Operatorit të Sistemit të Transmetimit**, (më poshtë referuar si OST SHA.), shoqëri aksionare, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr. 31935, dt. 14.07.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me adresë: Tiranë Kashar, Yrshek, autostrada Tiranë-Durrës, km 9, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42101801N, përfaqësuar nga Z.Skerdi Drenova, Administratori i OST SHA.,

Baza ligjore:

- a) Ligji Nr. 43/2015, date 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- b) VKM Nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”;
- c) VKM Nr. 584 datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjences në furnizimin me energji elektrike” (i ndryshuar);
- d) Kodi i Transmetimit, miratuar me Vendimin e ERE Nr. 63, datë 11.04.2022;
- e) Vendimi i ERE Nr. 99, datë 17.06.2016, “Mbi miratimin e Licencës së Prodhimit të Energjisë Elektrike”;
- f) Vendimi i ERE Nr. 134, datë 06.09.2017 “Mbi licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST-sh.a. në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;
- g) Vendimi i ERE Nr. 27, datë 16.02.2023 “Mbi çmimin e aplikueshëm të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi me hyrjen në fuqi të VKM-së nr.67, datë 08.02.2023”
- h) Kontrata “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, e amenduar;

Ndërsa, ndërmjet OST SHA dhe KESH SHA është lidhur Kontrata “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA,



datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA; e cila është miratuar nga ERE me Vendimin nr. 230, datë 12.09.2022;

Ndërsa, VKM Nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, në nenin 4, pika 7 e Pjesës I, përcakton se: “Ky vendim është i zbatueshëm edhe për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 90 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar; si dhe nenin 13 “Gjendja e emergjencës në furnizim”, përcakton se “Gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizim, shoqëria publike e prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, furnizon Operatorin e Sistemit të Transmetimit me të gjithë sasinë e nevojshme, për mbulimin e humbjeve, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi hidrike. Kontrata ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, negociohet nga palët dhe miratohet nga ERE.”

Ndërsa, VKM nr. 449, datë 26.07.2023 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 08.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike (i ndryshuar)”, përcakton se: “Në pikën 5 të Vendimit, fjalët “... 30 Qershor 2023.” zëvendësohen me “... 31 Dhjetor 2023.”.

Si dhe, Kontrata “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr. 3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022, neni 17 “Të ndryshme”, pika 2, parashikon se: “Çdo amendim ose shtesë në këtë Kontratë do të bëhet vetëm me shkrim dhe do të nënshkruhet nga të dyja Palët”; dhe neni 18 “Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme”, pika 2 parashikon se: “Kjo kontratë mund të ndryshohet apo zgjidhet përpara datës së përfundimit të saj, vetëm me miratimin e ERE”.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e Amendimit Nr.3 të Kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 18 “Miratimi i ERE-s, hyrja në fuqi, efektet dhe zgjidhja e parakohshme” e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022, pika 1, ndryshon si më poshtë vijon:

1. Kjo Kontratë, dhe secili nga kushtet këtu, do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE dhe i shtrin efektet për periudhën 01.07.2023 - 31.12.2023.

Neni 2

Të gjithë nenet e tjera të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit” nr.4670/1 prot., të OST SHA, datë 27.07.2022 dhe nr.3635/2 prot., të KESH SHA, datë 03.08.2022 (e amenduar), mbeten të pandryshuara.



Neni 3

Ky Amendament Nr.3 i kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Sistemin e Transmetimit”, nënshkruhet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme, 2 (dy) për secilën palë.

Për
KORPORATËN
ELEKTROENERGJITIKE
SHQIPTARE, KESH SH.A.

ADMINISTRATORI

Ergys VERDHO



Për
OPERATORIN E SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT,
OST SH.A.

ADMINISTRATORI

Skerdi DRENOVA

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
DREJTOR I KABINETIT

Luan Aranitasi





VENDIM

Nr. 297, datë 19.10.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SUN AVENUE” SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 8 dhe 9, pikat 4 dhe 5 dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2055/6 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.3.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2055 prot., datë 22.8.2023, shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. paraqiti kërkesën për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Intesa SanPaolo Bank” sh.a., në kuadër të veprimeve të nevojshme për një implementim të suksesshëm të projektit, duke rënë

dakord me “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., që ta financojë projektin nëpërmjet një kredie bankare, për garantimin e së cilës është kërkuar ndër të tjera dhe vendosja e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2055/2 prot., datë 7.9.2023, duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2055/3 prot., datë 14.9.2023 dhe nr. 2055/5 prot., datë 6.10.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për këtë aplikim.

- Shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa u përket pagesave rregullore.

- Kontrata nr. 2773 rep., nr. 876 kol., datë 23.9.2022, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k.”, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k., nuk përmban detyrimin për miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror për shoqërinë, por si dhe në raste analoge dhe në zbatim të nenit 8, germës “e”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, ERE do të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me dhënie e këtij autorizimi.



- Shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. duhet të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguroese mbi kuotat e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k. si mjet (barrë siguroese) për garantimin e detyrimit ndaj “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Sun Avenue” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Sun Avenue” sh.p.k. të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguroese mbi kuotat e saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Sun Avenue” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 298, datë 19.10.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SHPK, PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET (BARRË SIGURUESE), PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 8 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit, që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2056/7 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunpower 2017’ sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguroese), për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.3.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga central fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën e Povelçës, Bashkia Fier.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2056 prot., datë 22.8.2023, shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. paraqiti kërkesën për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguroese), për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “Intesa San Paolo Bank” sh.a., në kuadër të veprimeve të nevojshme për një implementim të suksesshëm të projektit,



duke rënë dakord me “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. që ta financojë projektin nëpërmjet një kredie bankare, për garantimin e së cilës është kërkuar ndër të tjera dhe vendosja e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2056/2 prot., datë 7.9.2023, duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2056/3 prot., datë 14.9.2023 dhe nr. 2056/6 prot., datë 6.10.2023, depozitoi dokumentacion plotësues për këtë aplikim.

- Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.

- Kontrata nr. 2772 rep., nr. 875 kol., datë 23.9.2022, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k.”, e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbajtësit të miratimit për ndërtim, shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., nuk përmban detyrimin për miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror për shoqërinë, por si dhe në raste analoge dhe në zbatim të nenit 8, germës “e”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit, dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. duhet të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguruese mbi kuotat e saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese), për garantimin e detyrimit ndaj “Intesa San Paolo Bank Albania” sh.a.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Sunpower 2017” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

3. Shoqëria “Sunpower 2017” sh.p.k. të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguruese mbi kuotat e saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Sunpower 2017” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 299, datë 19.10.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“TRUEN” SHPK, PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR
NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1959/9 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Truen” sh.p.k., për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Truen” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 30.1.2013, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 12, datë 30.1.2013.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1959 prot., datë 24.7.2023 dhe nr. 1959/1 prot., datë 3.8.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51% të kuotave të zotëruara nga ortakut i shoqërisë “CN’AIR” tek ortakut tjetër i shoqërisë “Ylliad”, i cili zotëron 49% të kuotave dhe me këtë transferim bëhet ortak me 100% të kuotave.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1959/2 prot., datë 16.8.2023,

iu evidentua shoqërisë dhe dokumentacioni i munguar për këtë aplikim. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 19593 prot., datë 28.8.2023, ka kërkuar nga ERE më shumë më kohë në dispozicion për plotësimin e këtij dokumentacioni, ndërsa me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1959/5 prot., datë 12.9.2023, nr. 1959/7 prot., datë 28.9.2023 dhe nr. 1959/8 prot., datë 6.10.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1 (germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”) dhe pika 2 (germat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e” dhe “f”) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Brenda datës 31.12.2023, shoqëria “Truen” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj.

- Shoqëria “Truen” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Truen” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Truen” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Truen” sh.p.k. bëhet “Ylliad” sh.p.k.

3. Brenda datës 31.12.2023, shoqëria “Truen” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj.



4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Truen” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit nga ana e shoqërisë “Truen” sh.p.k. të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Truen” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 300, datë 19.10.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“WENERG” SHA, PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE, PËR
NDRYSHIMIN E AKSIONARIT QË
KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 7 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmblotjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë

(ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1960/8 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘WEnerg’ sh.a., për dhënie e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “WEnerg” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 5.7.2010, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 137, datë 8.10.2012.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1960 prot., datë 24.7.2023 dhe nr. 1960/1 prot., datë 3.8.2023, shoqëria paraqiti kërkesën dhe dokumentacionin për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51 % të aksioneve të zotëruara nga “CN’AIR” te aksionari tjetër i shoqërisë “YLLIAD”, i cili zotëron 49 % të aksioneve dhe me këtë transferim bëhet aksionar i vetëm, me 100 % të aksioneve.

- Shoqëria ka informuar se shitja e aksioneve që “CN’AIR” zotëron në kapitalin e “WEnerg” sh.a. vjen si rrjedhojë e një riorientimi strategjik të shoqërisë “CN’AIR”, e cila do të fokusojë aktivitetin e saj në tregje të tjera. Në këto rrethana, aksionarët e shoqërive “CN’AIR” dhe “YLLIAD” kanë vendosur të krijojnë kushtet e duhura për kalimin e aksioneve dhe garantimin e aktivitetit të shoqërisë “WEnerg”, në përputhje të plotë me detyrimet e kësaj të fundit për licencën e prodhimit, licencën e tregtimit dhe detyrimeve të saj koncesionare. Gjithashtu, aksionari i shoqërisë “YLLIAD” ka shprehur dëshirën për marrjen e plotë të kontrollit të “WEnerg”, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë me synim optimizimin e mëtejshëm të aktivitetit të prodhimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1960/2 prot., datë 16.8.2023, iu evidentua shoqërisë dhe dokumentacioni i munguar për këtë aplikim. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1960/3 prot., datë



28.8.2023, ka kërkuar më shumë kohë në dispozicion për plotësimin e këtij dokumentacioni, ndërsa me shkresat me nr. 1960/5 prot., datë 12.9.2023 dhe nr. 1960/7 prot., datë 6.10.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues për këtë aplikim.

- Shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “WEnerg” sh.a. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “WEnerg” sh.a., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “WEnerg” sh.a., për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51 % të aksioneve të zotëruara nga aksionari i shoqërisë “CN’AIR” te aksionari tjetër i shoqërisë “YLLIAD”, i cili zotëron 49 % të aksioneve të shoqërisë “WEnerg” sh.a.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “WEnerg” sh.a. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “WEnerg” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 349, datë 22.11.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 228, DATË 17.7.2023, “MBI PËRCAKTIMIN E SHOQËRISË ‘BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE ALPEX’ SHA, SI OPERATORI I EMËRUAR I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1395/14 prot., datë 16.11.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.7.2023, ‘Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 228, datë 17.07.2023 ka vendosur të përcaktojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), duke i lënë detyrë në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi përkatësisht:

2. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., duhet të depozitojë në ERE Programin Ekonomik



të vitit 2023 të ndryshuar të miratuar nga organet drejtuese të saj.

3. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të dokumentojë në ERE informacion mbi arsyet e ndryshimit të organigramës duke shpjeguar detyrat funksionale të personelit.

- ERE, me shkresën me nr. 1395/11 prot., datë 8.8.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 228/2023, duke i sjellë në vëmendje dhe detyrimin për plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Po ashtu, me shkresën nr. 1395/12 prot., ERE njoftoi për këtë vendim përkatësisht Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës (AK), Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën e Furnizuesve Shqiptarë të Energjisë Elektrike (AEES), Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA).

- Brenda afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit nr. 228/2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2116 prot., datë 6.9.2023, shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” sh.a., ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, duke plotësuar këto kushte, ndaj këto pika *vlerësohen* të shfuqizohen.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së

Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 dhe pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 228/2023, “Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX’ sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, shfuqizohen.

2. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë